

L I G J

PER THEMELIMIN E KOMISIONIT SHTETEROR PER VENDIMMARRJE NE PROCEDURE ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURE NGA MARREDHENIA E PUNES NE SHKALLE TE DYTE

Neni

1

(1) Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedure Administrative dhe Procedure nga Marredhenia e Punës në Shkallë të Dytë (në tekstin e më poshtëm: Komisioni Shtetëror) është kompetent për zgjidhjen e ankesave kundër aktvendimeve të miratuara në procedure administrative në shkallë të parë nga ana e ministrive, organeve tjera të administratës shtetërore, organizatave të percaktuara me ligj dhe organeve tjera shtetërore.

(2) Komisioni Shtetëror është kompetent të vendosë dhe për çështje nga sfera e marredhenieve të punës në shkallë të dytë (të cilat nuk janë në kompetencë të Agjencisë për Administratë), për çështje nga sfera e marredhënies së punës për nepunësit shtetërore nga Agjencia për Administratë, si dhe kundër aktvendimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilat janë anuluar aktvendimet për ndarjen e cmimeve.

(3) Në procedure për zgjidhjen e ankesave Komisioni Shtetëror do t'i zbatojë dispozitat e Ligjit për procedure të pergjithshme administrative, nëse me këto ligj ose me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

(4) Kompetenca e Komisioni Shtetëror është të vendosë për ankesat kundër aktvendimeve të miratuara në procedure administrative në shkallë të parë nga ministrat, organet tjera të administratës shtetërore, organizatat percaktuara me ligj dhe organet tjera shtetërore, percaktohet me ligje të vecanta.

Neni

2

(1) Komisioni Shtetëror është organ shtetëror i cili është i pavarur dhe në punën e tij e ka çelësinë e personit juridik.

(2) Komisioni Shtetëror ka shërbim profesional. Për të punësuarit në shërbimin profesional do të zbatohen dispozitat e ligjit për nepunësit shtetërore.

(3) Komisioni Shtetëror financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

Neni

3

(1) Komisioni Shtetëror përbehet nga kryetari dhe gjashtë anetar të cilët funksionin e kryejnë profesionalisht.

(2) Kryetari dhe anetarët e Komisionit Shtetëror i emeron nepermjet konkursit publik dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonise me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emerimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonise.

(3) Kryetari dhe anetarët e Komisionit Shtetëror emerohen për periudhën prej pesë vitesh me të drejtë të zgjedhjes së serishme.

(4) Për kryetar të Komisionit Shtetëror emerohet personi i cili është shtetas i Republikës së Maqedonise, jurist i diplomuar dhe ka së paku gjashtë vite përvojë pune në punë administrative.

(5) Për anetar të Komisionit Shtetëror emerohet person i cili është shtetas i Republikës së Maqedonise, ka mbaruar arsim të lartë dhe ka së paku katër vite përvojë pune në punë administrative.

(6) Anetarët e Komisionit Shtetëror nga radhët e tyre zgjedhin zevendes kryetar.

(7) Kryetari dhe anetaret e Komisionit Shtetëror nuk mund të jenë anetare në organe dhe trupa të cilat i zgjedh ose emeron Kuvendi i Republikës së Maqedonise ose Qeveria e Republikës së Maqedonise.

Neni

4

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonise e shkarkon kryetarin ose anetarin e Komisionit Shtetëror para përfundimit të mandatit, nëse:

- ketë vetë e kërkon,
- përgjithmone e humb aftësinë për kryerjen e funksionit, që e përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonise,
- është dënuar me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm për veprë penale denim me burg pa kusht prej së paku gjashtë muajsh,
- i plotëson kushtet për pension sipas pleqërisë,
- kryen punë që nuk janë në përputhje me funksionin anetar ose kryetar i Komisionit Shtetëror ose
- vdes kryetari ose anetari.

(2) Propozim për shkarkim të kryetarit dhe anetarit të Komisionit Shtetëror mund të paraqesë edhe Qeveria e Republikës së Maqedonise.

(3) Për ekzistimin e arsyeve për shkarkim të kryetarit ose anetarit të Komisionit Shtetëror para kalimit të mandatit, kryetari (ose zëvendësi në rast të shkarkimit të kryetarit) është i obliguar që ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonise.

(4) Kuvendi i Republikës së Maqedonise e fillon procedurën për përcaktimin e propozimit për emerim të kryetarit dhe anetareve të Komisionit Shtetëror së paku tre muaj para skadimit të mandatit të tyre. Procedura për emerim duhet të mbarojë me së paku 30 ditë para mbarimit të rregullt të mandatit të kryetarit dhe anetareve.

Neni

5

Me Rregullore rregullohet mënyra e punës dhe vendimmarrjes së Komisionit Shtetëror.

Neni

6

Komisioni Shtetëror për punën e vet paraqet raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonise deri në fund të marsit në vitin vijues për vitin paraprak.

(2) Me kërkesë të Kuvendi të Republikës së Maqedonise Komisioni Shtetëror është obligohet që të paraqesë raport edhe për periudhë më të shkurtër se një vit.

(3) Raporti vjetor në vecanti i përmban:

- numrin e lendeve të pranuar,
- numrin e lendeve të zgjidhura (ankesa të hedhura poshtë, të refuzuara dhe të pranuar),
- numrin e lendeve të zgjidhura,
- numrin e lendeve për të cilat është ngritur kontest administrativ (lende të refuzuara dhe pranuar) dhe
- analize statistikore të procedurave për mbrojtje juridike.

Neni

7

Ndalohet cdo forme e ndikimit mbi miratimin e vendimeve te Komisionit Shteteror, e vecanerisht cdo keqperdorim per autorizime publike, per ndikimin ne rrjedhen dhe rezultatet e procedures.

Neni

8

(1) Per lendet e ankesave Komisioni Shteteror vendos ne mbledhje me shumice nga numri i pergjithshem i anetareve.

(2) Komisioni Shteteror mund te punoje vetem nese ne mbledhje jane prezent se paku pese anetare. Ne mbledhjen e Komisionit Shteteror merr pjese detyrimisht kryetari dhe/ose zevendesi i tij.

(3) Anetari i Komisionit Shteteror nuk mund te jete i permbajtur gjate votimit.

(4) Mbledhjet e Komisionit Shteteror nuk jane publike.

(5) Per proceduren e keshillimit dhe votimit mbahet procesverbal i vecante. Procesverbalin e nenshkruajne te gjitha te pranishmit ne Komisionin Shteteror dhe mbajtesi i procesverbalit.

(6) Komisioni Shteteror vendos ne afat prej dy muajsh nga dita e dorezimit te ankeses, nese me dispozite te vecante nuk eshte percaktuar afat me i shkurter.

(7) Kur Komisioni Shteteror vepron sipas ankeses se parashtruar kunder vendimit qe nje here eshte anuluar dhe kthyer ne zgjidhje te serishme, duke vepruar per ankesen, Komisioni Shteteror vete do ta zgjidhe lenden.

(8) Nese Komisioni Shteteror nuk merr vendim ne afatin nga paragrafi (6) i ketij neni, parashtruesi i ankeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ ne afat prej pese ditesh pune.

(9) Inspektorati Shteteror Administrativ eshte i obliguar qe ne afat prej dhjete ditesh nga dita e pranimit te njoftimit nga paragrafi (8) i ketij neni, te kryeje mbikeqyrje ne Komisionin Shteteror nese eshte zbatuar procedura ne pajtim me ligjin dhe ne afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes se kryer e informon parashtruesin e ankeses per masat e marra.

(10) Inspektori nga Inspektoratit Shteteror Administrativ pas mbikeqyrjes se kryer ne pajtim me ligjin merr vendim me te cilin i ngarkon kryetarin dhe anetaret e Komisionit Shteteror ne afat prej dhjete ditesh te vendosin per ankesen se parashtruar dhe ta njoftojne inspektorin per aktin e miratuar. Me njoftim dorezohet kopje nga akti me te cilin kane vendosur per kerkesen e paraqitur.

(11) Nese, kryetari dhe anetaret e Komisionit Shteteror nuk vendosin ne afatin nga paragrafi (10) i ketij neni, inspektori do te parashtroje kerkese per ngritjen e procedures kundervajtese per kundervajtje te percaktuar ne Ligjin per inspeksion administrativ kunder kryetarit dhe anetareve te Komisionit Shteteror, dhe do te percaktoj afat plotesues prej pese ditesh pune, ne te cilin kryetari dhe anetaret e Komisionit Shteteror do te vendosin sipas ankeses se paraqitur per cfare ne afatin e njejte e njofton inspektorin per aktin e miratuar. Me njoftim dorezohet kopje nga akti me te cilin kryetari dhe anetaret e Komisionit Shteteror kane vendosur per kerkesen e paraqitur. Inspektori ne afat prej tri ditesh pune e informon parashtruesin e ankeses.

(12) Nese kryetari dhe anetaret e Komisionit Shteteror nuk vendosin edhe ne afatin plotesues nga paragrafi (11) i ketij neni, inspektori ne afat prej tri ditesh pune do te paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe ne ate afat e informon parashtruesin e ankeses per masat e marra.

(13) Nese inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (9) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses ne afat prej pese ditesh ka te drejte te parashtroje ankese te sekretaria e drejtorit te Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, ankesa parashtrohet ne sekretari ne seline e Inspektoratit Shteteror Administrativ.

(14) Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ eshte i obliguar qe ne afat prej tri ditesh pune ta shqyrtoj ankesen nga paragrafi (13) i ketij neni, dhe nese verteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga parashtruesi i kerkeses nga paragrafet (9) dhe (10) te ketij neni dhe/ose nuk parashtron kallezim ne pajtim me paragrafet (11) dhe (12), drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do te paraqese kerkese per ngritjen e procedures kundervajtese per inspektorin, dhe do

te percaktoje afat prej pese ditesh pune ne te cilin inspektori do te kryeje mbikeqyrje ne Komisionin Shteteror nese eshte zbatuar procedura ne pajtim me ligjin dhe ne afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes se kryer ta informoje parashtruesin e kerkeses.

(15) Nese inspektori nuk vepron edhe ne afatin plotesues nga paragrafi (14) te ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do te paraqese kallezim te prokurori publik kompetent kunder inspektorit dhe ne afat prej tri ditesh pune do ta informoje parashtruesin e ankeses.

(16) Ne rast nga paragrafi (15) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ menjehere, e me se voni ne afat prej nje dite pune, do te autorizoj inspektor tjetër ta zbatoje mbikeqyrjen menjehere.

(17) Ne rastin nga paragrafi (16) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ ne afat prej tri ditesh pune e informon parashtruesin e ankeses.

(18) Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron ne pajtim me paragrafin (14) te ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund te parashtroje kallezim te prokurori publik kompetent ne afat prej tete ditesh pune.

(19) Nese kryetari dhe anetaret e Komisionit Shteteror nuk vendosin ne afatin nga paragrafit (12) i ketij neni, parashtruesi i ankeses mund te ngrihte kontest administrativ para gjykates kompetente.

(20) Procedura para Gjykates Administrative eshte urgjente."

Neni

9

Gjate zgjidhjes se ankesave Komisioni Shteteror mban procesverbal.

Procesverbali duhet te permbaje te dhena te rendesishme per veprimet e marra, respektivisht vendimet e marra ne debat.

Procesverbalin e nenshkruajne kryetari, anetaret prezent dhe mbajtesi i procesverbalit dhe eshte pjese perberese e lendes.

Neni

10

Kunder aktvendimit te Komisionit Shteteror per punet nga neni 1 paragrafi 1 te ketij ligji, mund te ngritet kontest administrativ ne gjykatën kompetente per mbajtjen e kontesteve administrative.

Kunder aktvendimit te Komisionit Shteteror per punet nga neni 1 paragrafi 2 te ketij ligji mundet me padi te ngritet kontest para gjykates kompetente.

Neni

11

Procedurat e filluara dhe procedurat te cilat do te fillojne para komisioneve te Qeverise se Republikes se Maqedonise per vendosje ne procedure administrative ne shkalle te dyte per pune te caktuara administrative deri ne fillimin e zbatimit te ketij ligji, do te mbarojne nga komisionet ne afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Zgjidhja e lendeve te filluara para hyrjes ne fuqi te ketij ligji per te cilat eshte ngritur kontest administrativ do vazhdoje ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.

Ligjet me te cilat eshte percaktuar e drejta e ankeses para komisioneve te Qeverise se Republikes se Maqedonise per vendimmarrje ne procedure administrative ne shkalle te dyte per pune te caktuara administrative, do te harmonizohen me dispozitat e ketij ligji deri ne ditën e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Neni

12

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas gjashtë muajsh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.